



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:180966
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05519749

Ac.nr.943/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit Sh.Q. dhe I.Q. të dy nga Prishtina, të cilët i përfaqëson B.Ç., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” ... me seli në Prishtinë, rr. ”....” nr...., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar M.B., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësve dhe ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/18 datë 30.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa paditësve Sh.Q. dhe I.Q. të dy nga Prishtina dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” ... me seli në Prishtinë, rr. ”....” nr...., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/18 i datës 30.10.2019, në pikën I - I/b., të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material për paditësin Sh.Q., në pikën I – II/b., në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material për paditësin I.Q., kamatën, shpenzimet e procedurës dhe në pikën II, të dispozitivit në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit material për rehabilitimin klimaterik, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e paditësve Sh.Q. dhe I.Q. të dy nga Prishtina, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/18 i datës 30.10.2019, në pikën I-I/a., dhe I-II/a dhe III, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit jomaterial për paditësit dhe atë për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar dhe gjykohet si në vijim DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” ... me seli në Prishtinë, rr. ”....” nr...., që paditësve Sh.Q. dhe I.Q. të dy nga Prishtina, në emër të kompensimit

të dëmit jomaterial të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 22.09.2018, t'i paguaj shumën e specifikuar dhe atë

- Padiësit Sh.Q. për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1.300 € dhe për frikën e përjetuar shumën prej 1.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar, për dhembjet fizike dhe frikën e përjetuar, REFUZHET SI E PABAZUAR.

- Padiësit I.Q. për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1.500 € dhe për frikën e përjetuar shumën prej 1.000 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar, për dhembjet fizike dhe frikën e përjetuar, REFUZHET SI E PABAZUAR.

III. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e padiësve Sh.Q. dhe I.Q. të dy nga Prishtina, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.417/18 i datës 30.10.2019, sa i përket kompensimit të dëmit material dhe atë për shpenzimet e mjekimit dhe gjykohet si në vijim DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S..." ... me seli në Prishtinë, rr. "...." nr...., në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 22.09.2018, padiësit I.Q. t'i paguaj shumën prej 144.3€ ndërsa padiësit Sh.Q. shumën prej 30.1 €, në emër të shpenzimeve të mjekimit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.417/18, të datës 30.10.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e padiësve S Sh.Q. dhe I.Q. qe te dy nga Prishtina, si e bazuar dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S...." me seli në Prishtinë, qe padiësve për dëmin e pësuar në aksident t'ia kompensoj si në vijim

Për padiësin Sh.Q.

I/a-Dëmin jo material-moral

- Për dhimbje fizike shumën prej 1.000,00.-€
- Për frikën e përjetuar shumën prej 700.00.-€

I/b. Në emër të dëmit material

- Për ushqim të përforcuar shumën prej 84.-€
- Për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 84 .-€

Për padiësin I.Q.

- II/a-Dëmin jo material-moral
- Për dhimbje fizike shumën prej 1.000.00.-€
- Për frikën e përjetuar shumën prej 700.00.-€

II/b. Në emër të dëmit material

- Për ushqim të përforcuar shumën prej 180.00.-€
- Për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 180.00.-€

Të gjitha këto t'ia kompensoi në afat prej 15 dite me kamat ligjore prej 8%, nga data nxjerrjes së aktgjykimit, deri në pagesën definitive si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej -€, këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e

përmbartimit të dhunshëm. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve Sh.Q. mbi shumat e aprovuara për dhimbje fizike nga 1.000,00.-€ deri 1.300,00.-€, në emër të frikës nga 700.00.-€ deri 1.000,00.-€ në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej 700.00.-€ në tërësi në mungesë të provave materiale faturave nga institucioni kompetentë, dhe I.Q. mbi shumat e aprovuara për dhimbje fizike nga 1.000.00.-€ deri 1.500,00.-€, në emër të frikës nga 700.00. deri 1.000,00.-€, në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej 700.00.-€ në tërësi në mungesë të provave materiale - faturave nga institucioni kompetent, refuzohen si të pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuar i paditësve në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e precizuar me shkrim.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 02.11.2018, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit, të precizuar si në parashtresën e datës 23.10.2019, me të cilën kanë kërkuar që të Aprovohet kërkesëpadija e paditësve Sh.Q. dhe I.Q. nga Prishtina në tërësi si e bazuar dhe njëherit Obligohet e paditura KS "S...." nga Prishtina që paditësve t'ua kompensoj dëmin e pësuar si pasojë e aksidentit të datës 22.09.2018 dhe të paguaj dëmin si vijon 1. Për I.Q. në emër të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike shumë prej 1.500 €, për frikën e përjetuar shumë prej 1.000 €. Për dëmin jomaterial 2.500 €. Në emër të dëmit material për ushqimin e përforcuar 180 €, në emër të ndihmës së huaj 180 €, në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej 700 €, në emër të shpenzimeve materiale gjatë shërimit shumë prej 144.3€. Për dëmin material shumë prej 1,204.3 €, 2. Për Sh.Q. në emër të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike shumë prej 1.300 €, për frikën e përjetuar shumë prej 1.000 €. Për dëmin jomaterial shumë prej 2.300 €. Në emër të dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 84 €, në emër të ndihmës së huaj shumë prej 84 €, në emër të rehabilitimi klimaterik shumë prej 350€. Në emër të shpenzimeve materiale sipas faturave shumë prej 30.1€. Gjithsej për dëmin material shumë prej 548.1 €. Në të gjitha shumat e miratuara detyrohet e paditura që paditësve tua paguaj kamatën në lartësi të deponimeve në bankë, për kohëzgjatjen më tepër se një vit duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë e gjer në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, duke përfshirë edhe pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.417/18, të datës 30.10.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, e njëjta u vërtetua edhe në bazë raportit të aksidentit nr.2018-R-2300 të datës 22.09.2018, me të cilin vërtetohet se ditën kritike kishte ndodhur aksident komunikacioni në magjistralen Ferizaj Prishtinë përkatësisht në fshatin Llugaxhi, ku në këtë aksident kanë pësuar lëndime trupore të dëmtuarit I.Q. dhe Sh. Q. Gjithashtu kontestuese ishte edhe lartësia e kërkesëpadisë, ashtu që për ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata përmes dëgjimit të eksperteve në shqyrtim gjyqësor dhe atë të Dr. Sabit Sllamniku ortoped-traumatolog dhe Dr. Samire Braina psikiatër pranë QKUK-së, e në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit direkt të të njëjtëve, kanë dhënë mendimin profesional si në seancën gjyqësore të dt.23.09.2019, ku sipas mjekëve paditësit kanë pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore. Gjykata lidhur me lartësinë e demit material dhe jo material për paditësit ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 të LPK-së dhe në bazë të dispozitave të nenit 159 par. 1, 169 par. 2 dhe 179 par.1 i LMD-së.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket demit jomaterial dhe material, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Sabit Sllamniku ortoped - traumatolog, dhe Dr. Samire Braina psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.09.2019, kanë konstatuar se: Paditësi I.Q., si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar lëndime trupore dhe atë përkyrje e unazave të qafës dhe ndrydhje të gjoksit dhe të gjurit, të cilat lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 4 javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka përjetuar edhe për 2 javë të tjera. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 1 muaj. Ndiqja dhe kujdesi i huaj ka qenë i nevojshëm për 1 muaj. Rehabilitimi klimaterik ka qenë i nevojshëm dy herë nga 10 ditë brenda vitit të parë. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare me intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 48 orë, frikë sekondare me intensitetit të mesëm 3-4 muaj dhe frikë sekondare me intensitet të ulët ka vazhduar edhe sot e kësaj dite.

Paditësi Sh.Q. i, si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime trupore dhe atë përkyrje e unazave të qafës, të cilat lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 2 javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka përjetuar edhe për 2 javë të tjera. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 javë. Ndiqja dhe kujdesi i huaj ka qenë i nevojshëm për 2 javë. Rehabilitimi klimaterik ka qenë i nevojshëm 10 ditë brenda vitit të parë. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare me intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 24 orë, frikë sekondare me intensitetit të mesëm 3-4 muaj dhe frikë sekondare me intensitet të ulët ka vazhduar edhe sot e kësaj dite.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 159 paragraf 1, 169 paragraf 2 dhe 179 paragraf 1 dhe 200 të LMD-së,

lidhur me nenin 323 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 dhe 453 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe, Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë rreth orës ... në rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj, përkatësisht në fshatin tek autolarja “....”. Automjeti më të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguarur te këtu e paditura. Shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit “....”, me targa të regjistrimit, me ngjyrë të bardhë, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte Sh.M. nga fshati, Komuna e Lipjanit, i siguruari i këtu të paditurës, gjersa këtu paditësit Sh.Q në cilësinë e vozitësit dhe I.Q. në cilësinë e bashkudhëtarit nuk kanë kontribuar fare në shkaktimin e këtij aksidenti dhe si pasojë e këtij aksidenti, paditësit pësojnë lëndime të lehta trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit - përgjegjësinë e të siguarurit të saj, siç është deklaruar përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.08.2019, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, nuk ka kontestuar se paditësit kanë përjetuar dhimbje fizike dhe frikë si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.10.2019, paditësit I.Q. i ka ofruar ofertë në lartësi prej 1.000 €, ndërsa paditësit Sh.Q. i ka ofruar ofertën në lartësi prej 900 €, të cilat oferta paditësit nuk i kanë pranuar. Në këtë rast e paditura edhe pse e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë, në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji përcaktohet se “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga

pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore nga të dyja palët, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se “ Kush i shkaktonte tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, në këtë rast paditësve i takon e drejta në kompensimin e këtyre llojeve të dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe për ushqimin e përforcuar përkundër faktit se paditësit për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi Isuf Qorolli ka pasur nevojë për ka pasur nevojë për ndihmë dhe përkujdesje të huaj prej 1 muaj dhe ushqimi të përforcuar prej 1 muaj, ndërsa paditësi Shkelzen Qorolli ka pasur nevojë për ka pasur nevojë për ndihmë dhe përkujdesje të huaj prej 2 javë dhe ushqimi të përforcuar prej 2 muaj, të njëjtëve i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqim të përforcuar, duke vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pikën III, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësve I.Q. dhe Sh.Q., për kompensimin e dëmit material dhe atë për shpenzimet e rehabilitimit klimatik mbi shumat e gjykuara, Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast në këtë rast paditësit nuk kanë ofruar prova që vërtetojnë këtë kategori të dëmit material, e që kanë qenë të obliguar për një gjë të tillë, në kuptim të neneve 7 paragraf 1, e lidhur me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jomaterial për paditësit I.Q. dhe Sh.Q. dhe atë për dhembjet fizike dhe frikën e përjetuar, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jomaterial për paditësit dhe atë për dhembjet fizike dhe frikën e përjetuar, pasi që vlerësoi se shumat e gjykuara në raport me

paditësit I.Q. dhe Sh.Q., nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë Gjkata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që kanë pësuar paditësit, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësve dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 183 të LMD-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjkata e Apelit vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht ankesën e paditësve sa i përket kategorisë së dëmit material dhe atë për shpenzimet e mjekimit, pasi që në këtë rast Gjkata e Apelit vlerësoi se palës paditëse si pasojë e aksidentit iu kanë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë dëftesë pagesat dhe kuponët fiskal prezent në shkresat e lëndës, ku paditësit të njëjtat shpenzime i kanë kërkuar edhe në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 23.10.2019, mirëpo për shpenzimet e mjekimit gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur dhe nuk i ka administruar si prova materiale dëftesë pagesat dhe kuponët fiskal, për çka në këtë rast Gjkata e Apelit edhe ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kamatën është marrë me aplikimin e drejtë të së drejtës materiale pasi lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 30.10.2019, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tyre për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike - kontestimore, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjkata e Apelit, duke u mbështetur në nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.943/20, me datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli